

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**

**Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture**

**Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure**

## **Kërkesë për Kuotim (KpK)**

**Blerje e mallrave**

**Blerësi:** Agjencia Kadastrale e Kosovës

**Projekti:** Projekti i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP)

**Titulli i kontratës:** Blerja e pajisjeve gjeodete (Dron/UAV, pajisje gjeodete GNSS dhe pajisje digjitale të nivelimit me saktësi të lartë)

**Shteti:** Republika e Kosovës

**Nr. i huasë/Nr. i kredisë:** IDA-63540

**RFB Nr:** XK-KCA-101259-GO-RFQ

**Publikuar më:** 16 qershor 2023

I nderuar furnizues,

1. Ftoheni që të paraqisni kuotimin e çmimeve për furnizimin e pajisjeve si në vijim:

**Blerja e pajisjeve gjeodete (Dron/UAV, pajisje gjeodete GNSS dhe pajisje digjitale të nivelimit me saktësi të lartë), RFB Nr. XK-KCA-101259-GO-RFQ**

2. Kuotimi juaj i çmimeve në formularin e bashkangjitur mund të dorëzohet në dorë, në adresën e mëposhtme:

**Agjencia Kadastrale e Kosovës**

Për vëmendje të: Merolind Osmanaj, Specialist i Prokurimit - NjIP

Adresa: Rr. “Arbënor e Astrit Dehari”, nr.25, Ndërtesa e Arkivit, kati 2, 10 000, Prishtinë  
Republika e Kosovës,

Email: [Merolind.Osmanaj@rks-gov.net](mailto:Merolind.Osmanaj@rks-gov.net), dhe të kontrollojnë dokumentin e ofertimit gjatë orarit të punës (09:00-16:00) në adresën e dhënë më sipër

3. Afati për pranimin e kuotimit tuaj nga Blerësi: **17 korrik 2023, në orën 14:00** (ora lokale) në adresën e treguar në paragrafin 2.
4. Kuotimi juaj në dy kopje dhe në gjuhën angleze, duhet të shoqërohet me dokumentacion adekuat teknik dhe katalogun dhe materiale të tjera të shtypura ose informacionet përkatëse për secilin artikull të cituar, duke përfshirë emrat dhe adresat e firmave që ofrojnë shërbime të tilla në Republikën e Kosovës.
5. Kuotimi juaj duhet të dorëzohet sipas udhëzimeve të mëposhtme dhe në përputhje me Kontratën dhe Specifikimet Teknike të bashkangjitura. Termat dhe Kushtet e Furnizimit të bashkangjitur janë pjesë përbërëse e Kontratës.

(i) **ÇMIMET:** Çmimet duhet të kuotohen në Euro (dhe artikull) në destinacionet përfundimtare, ku përfshihen të gjitha taksat, TVSH-ja, detyrimet doganore, instalimi, transporti në vend dhe sigurimi, ngarkimi dhe shkarkimi.

Pajisjet do të dorëzohen dhe instalohen në objektin e AKK-së në Prishtinë.

(ii) **VLERËSIMI I KUOTIMEVE:** Kuotimet do të vlerësohen për të siguruar përputhje me Specifikimet Teknike, afatet e dorëzimit dhe përfundimit dhe çdo kërkesë tjetër të KpK-së.

Në vlerësimin e kuotimeve, Blerësi do të përcaktojë për çdo ofertë çmimin e vlerësuar duke rregulluar kuotimin e çmimit dhe duke bërë çdo korrigjim për çdo gabim aritmetik si në vijim:

(a) kur ka një mospërputhje mes shumave në shifra dhe me fjalë, shuma me fjalë do të mbizotërojë;

(b) kur ka një mospërputhje mes normës së njësisë dhe totalit të artikujve që rezultojnë nga shumëzimi i normës së njësisë me sasinë, norma për njësi siç kuotohet do të mbizotërojë;

(c) nëse Furnizuesi refuzon të pranojë korrigjimin, kuotimi i tij do të refuzohet.

(iii) **DHËNIA E URDHËRBLERJES:** Dhënia do t'i ofrohet ofertuesit që ofron çmimin më të ulët të vlerësuar dhe që plotëson standardet e kërkuara të kapacitetit teknik dhe financiar. Ofertuesi i suksesshëm do të nënshkruajë kontratën sipas formularit të bashkëngjitur të kontratës, specifikimeve teknike dhe kushteve të furnizimit.

(iv) **VLEFESHMËRIA E OFERTËS:** Kuotimi juaj duhet të jetë i vlefshëm për një periudhë kohore prej **gjashtëdhjetë (60) ditëve** nga afati për pranimin e kuotimit të cekur në paragrafin 3 të kësaj Ftese për Kuotim.

6. Ofertuesit e interesuar të kualifikuar mund të marrin informacion të mëtejshëm nga **Agjencia Kadastrale e Kosovës**  
Për vëmendje të: Merolind Osmanaj, Specialist i Prokurimit - NjIP  
Adresa: Rr. "Arbënor e Astrit Dehari", nr.25, Ndërtesa e Arkivit, kati 2, 10 000, Prishtinë  
Republika e Kosovës,

Numri i telefonit: +383 38 200 30 268

Email: [Merolind.Osmanaj@rks-gov.net](mailto:Merolind.Osmanaj@rks-gov.net), dhe të kontrollojnë dokumentin e ofertimit gjatë orarit të punës (09:00-16:00) në adresën e dhënë më sipër

## **7. Inspektimet dhe auditimet**

7.1 Furnizuesi do të zbatojë të gjitha udhëzimet e Blerësit të cilat janë në përputhje me ligjet në fuqi ku ndodhet destinacioni.

7.2 Furnizuesi do të lejojë dhe do të detyrojë nënkontraktorët dhe konsulentët e tij të lejojnë Bankën dhe/ose personat e caktuar nga Banka të inspektojnë zyrat e Furnizuesit dhe të gjitha llogaritë dhe të dhënat në lidhje me zbatimin e kontratës dhe dorëzimin e ofertës, dhe duhet ketë llogari dhe pasqyra të tilla të audituara nga auditorët e emëruar nga Banka nëse kjo kërkohet nga Banka. Furnizuesit dhe nënkontraktorëve dhe konsulentëve të tij iu bëhet me dije për Klauzolë 5 Mashtrimi dhe Korrupsioni i Formës së Kontratës, e cila parasheh, ndër të tjera, se aktet që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e të drejtave të inspektimit dhe auditimit të Bankës përbëjnë një praktikë të ndaluar që i nënshtrohet ndërprerjes së kontratës (si dhe përcaktimit të papërshtatshmërisë në përputhje me procedurat mbizotëruese të sanksioneve të Bankës).

8. Luteni që të konfirmoni me email pranimin e kësaj ftese dhe nëse do të dorëzoni kuotimin e çmimeve.

Sinqerisht,